

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME

Drejtoria e Prokurimit

Nr. 03 11 1 097

Datë 17 11 2022

KONTRATAPËR SHËRBIME

Nr.i kontratës: 617-22-11698-2-2-1/C474

Komuna ShtimeRr. „ Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-/131 ose 045-444 509 të cilën o përfaqëson:
Muhadin Hallil Udhëhoqës i Zyrës së Prokurimit në njërën anë ,

dhe

C.I.K. "Caritas Kosova "Rr, Rexhep Bislimi „, Ferizaj që e përfaqëson **Alfred Pjetri**, Drejtor Ekzekutiv nr i tel 044-783-857, ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publikepër Shërbim :

Shërbime sociale edukative për institucionin parashkollorë „Albiona Asllani,, në Shtime

Me numër identifikues: 617-22-11698-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është përforcimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

1.2

Shërbime sociale edukative për institucionin parashkollorë „Albiona Asllani,, në Shtime

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi : 24,880.00 €(dy/katër/tetë/tetë/zero/zero/zero)

2.1 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës çmimi për njësi . Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshirohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të caknin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të Identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien o ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikato, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Muhadin Halili	Emri:	Alfred Pjetri
Pozita:	Drejtor i Prokurimit	Pozita:	Drejtor ekzekutiv
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	17.11.2022	Data:	17.11.2022
Vula:		Vula:	

PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

Nr.i kontratës: 617-22-11698-2-2-1/C474

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tënderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshtjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjesë të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjesë të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkosë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguroesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguroesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në rastet kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akto, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e lirton Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato laksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzojë Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të fillojë shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë të zgjatje.

Neni 8

Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbushë detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë tërësisht për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose iloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë o forcë madhore ka ndodhur o cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethana. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdorisa është mjaft praktikë, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9

Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjisllacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cillin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shponzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen a duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe paravo që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar t'i bëjë pagosën tjetër për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve kostot ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafte të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimin për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të

veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kryesor të identifikuar në tendere tippër të kryefunksionet epërcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhenë bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë përnjehzëvendësim nëse vlerëson senjoritetin e stafit të shtetë pa efektshëm ose nuk kryendetyrate të sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë informacion dhe/ose dokumentacion mbi specifikimin të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumentet të tillat do të kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrës.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të caktuar në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatuar pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbje që është pasojë e mos ekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdojë të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktojë nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rrezikët, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofrojë dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet të bëhen Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti

formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin o Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbrilje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtetë plikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën dofitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues dotë njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt parapërfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve dotë zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigojohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin enjoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues dotë vlerësojë kostone korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguajkëtë shumë, dhe do pasoj një dënimpër mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të marrin vesh të përqipen të pajtohen përmes Institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë.

- a) vendim nga gjyqi;

21.2 P'urë nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi


22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë së sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATESKUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet / Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i Shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 18.11.2022
	6.4	Data e Përfundimit është 31.03.2023
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është Institucioni Parashkollor „ Albiona Asllani,, Shtime
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i projektit është :
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % e çmimit për njësinë ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10 % të çmimit final të kontratës .
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës, per periudhen deri më 30.04.2023
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë OE b) Përgjegjësia e Palës së Tretë OE c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve OE d) Përgjegjësia profesionale <i>Bie mbi OE</i> e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës <i>Bie mbi OE</i>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Pagesat OE do t'i bëhen në baza mujore për shërbimet e kryera të dëshmuar me raport të menaxherit të kontratës , për shërbimin e kryer në bazë të kontratës.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga autoriteti kontraktues do të jene ne vijim:Menaxheri i projektit do të inspektoj shërbimet
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Për çdo mosëmarrveshje eventuale në mes AK dhe OE do të zgjidhen me marrveshje</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>gjykatën kompetente</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi në Euro	Shuma në €
1	<p>Shërbime për asistencë administrative edhe juridike për tëmijët në institucionin parashkollor.</p> <p>Këto shërbime përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Planifikimi i blerjeve gjatë gjithë vitit dhe draftimi i nevojave për vitin vijues, -Plani dhe realizimi i pagesave/ participimit të tëmijëve në institucion, -Plani i blerjes së ushqimit dhe materialit gjatë shpenzues për institucionin -Planifikimi i buxhetit për një vit (gjatë qdo vit, në bashkëpunim me drejtorin dhe stafin tjetër sipas nevojave. -Plani i shpenzimit të buxhetit -Plani i shpenzimit dhe plani i nevojave për secilin sektorë në institucion -Përpilimi i draftit regulloreve dhe crafta dokumenteve tjera për mirë funksionimin e gjithmbarëshme në institucion -Ofron këshillim dhe ndihmë në punën e draftuarit -Sigurimi i zbatimit të të gjitha Ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve si dhe dokumenteve të tjera të brendshme dhe të jashtme e që janë në fuqi për edukim në tëmijërinë e hershme në Kosovë -Bashkëpunimi në sigurimin i cilësisë në shërbimet të cilat ofronen në institucion -Këtu përfshihen edhe paisjet dhe mirëmbajtja e të dhënave dhe të tjera sipas shërbimit. 	Ciri/h	300	2.60 €	2.080,00



A-D

Arbime psikologjike dhe sociale për fëmijët në institucionin parashkollor.
 këto shërbime përfshijnë punën e psikologut në institucion dhe ofrimin të këtyre shërbimeve:


- Këshilla për edukatorët në raste e fëmijëve me vështirësi në sjellje, hartimin dhe zbatimin e PJA-s (Plani Individual i Arsimit)
- Trajtimi i fëmijëve me vështirësi të të gjitha formave,
- 2 -Fëmijët me vështirësi në të nxënë,
- Fëmijët e prindërve me problem e bashkë-ortorë në proces të ndarjes,
- Fëmijët viktima të dhunës në familje,
- Fëmijët në kujdestari,
- Integrimin e fëmijëve të komuniteteve,
- Si dhe shërbime tjera sipas nevojës.

Shërbime social- edukative për fëmijët 3- 6 vjeç në institucionin parashkollor.

Këto shërbime përfshijnë:

- Realizimin e planprogramit edukativ dhe social
- Zbatimin e detyrave të punës cuke siguruar cilësi dhe kompetencë profesionale në procesin edukativ dhe social
- 3 -Zbatimi i metodologjive të reja për të nxënë në fëmijërinë e hershme,
- Hartimin e planprogramit edukativ dhe social për grupmoshat përkatëse 3- 6 vjeç,
- Të zbatojë planprogramin sipas fushave të zhvillimit duke siguruar cilësi dhe trajtim të barabartë.
- Integrimin e fëmijëve të komuniteteve bashkë me stafin tjetër,
- Hartimin dhe zbatimin e PJA-s bashkë me stafin tjetër
- Si dhe shërbime tjera sipas nevojës.

<p>Orë/h</p> <p>4800</p> <p>2.50 €</p> <p>12,000.00</p>				



Shërbime infermierore dhe social- edukative për fëmijët 06 muaj- 3 vjet në

asistucionin parashkollor.

Këto shërbime përfshijnë:

- Realizimin e planprogramit të përkujdesjes së ndëtesore, edukative dhe sociale për fëmijët 06- 3 vjet
- Zbatimin e detyrave të punës duke siguruar shërbimet të plotë për fëmijët, cilësi dhe kompetencë profesionale në procesin shëndetësor, edukativ dhe social
- Zbatimi i metodologjive të reja për të nxënërit në fëmijërinë e hershme.
- Hartimin e planprogramit shëndetësor, edukativ dhe social për grupmoshat përkatëse 06- 3 vjet.
- Të zbatojë planprogramin sipas fushave të zëvillimit duke siguruar cilësi dhe trajtim të barabartë.
- Integrimin e fëmijëve të komuniteteve baskike në stafin tjetër
- Hartimin dhe zbatimin e PJA-s baskike me stafin tjetër
- Të ushqyerit e shëndetshëm sipas standardeve të OBSH-së.
- Si dhe shërbime tjera sipas nevojës.


Ore/h 1600 2.70 € 4,320.00

Shërbime për asistencë në Skemën e të Ushqyerit dhe Shpërndarjen e Ushqimit të Shëndetshëm

Këto shërbime përfshijnë:

- Asistencë në përzgjedhjen e ushqimit të shëndetshëm për fëmijët e moshës 0- 6 vjet sipas standardeve të të ushqyerit në fëmijëri e e hershme 0- 6 vjet (Hartimi i MENY-së), efi
- Asistim në blerjen e artikujve ushqimor.
- Asistim në përgatitjen e ushqimit për fëmijët.
- Asistencë në shpërndarjen e ushqimit të shëndetshëm për fëmijët e moshës 0- 6 vjet sipas standardeve të të ushqyerit në fëmijëri e e hershme 0- 6 vjet (Hartimi i MENY-së)
- Asistim në zbatimin e plotë të menysë së hartuar për fëmijët sipas grupmoshave.
- Asistim në shpërndarjen e ushqimit për fëmijët.
- Asistim në përgatitjen e zamrës dhe shpërndarjen e sajë për fëmijët.
- Këtu përfshihen edhe paisjet dhe mirëmbajtja e tyre për përgatitjen dhe shpërndarjen e suhqimit.
- Këtu përfshihen edhe paisjet dhe mirëmbajtja e tyre për ruajtjen, përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit.

Ore/ h 800 2.20 € 1,760.00



A-9

Programi socialë për mbajtjen e ngrënies në ambientin e brendshëm të institucionit parashkollor

(Këto shërbime përfshijnë:

- Përmirësimin e kushteve për qëndrim ditor, një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm, duke ndihmuar përfutuesin e shërbimit në mbajtjen e higjenes së ambientit të brendshëm të institucionit duke bërë pastimin e gjithë hapësirave: dyshemesë, në dhoma, banjo, korridor etj.
- Pastimin e detyrë dhe dritareve;

6 -Mbajtja e higjenes së ulësëve, shtretërve dhe tepinëve.

- Këtu përfshihen edhe paisje dhe materialet higjienike për pastim.
- Përmirësimin e kushteve për qëndrim ditor, një mjedis të pastër dhe të rehatshëm, duke ndihmuar përfutuesin e shërbimit në mbajtjen e higjenes së gjumit për fëmijë të institucionit duke bërë pastimin, larjen dhe hekurrosjen e gjitha trobave, qarqafëve, mbulesave të shtetit, peshqirave, etj.
- Mbajtja e higjenes së shtretërve dhe peshqirëve.
- Këtu përfshihen edhe paisjet dhe materialet higjienike për pastim.

Shërbimet sociale për mirëmbajtjen në ambientin e jashtëm dhe të brendshëm të institucionit parashkollor


Këto shërbime përfshijnë:

- Përmirësimin e kushteve për qendrën ditore, një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm, duke ndihmuar përfutuesin e shërbimit në mirëmbajtjen e ambientit të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit duke bërë mirëmbajtjen e të gjitha hapësirave brenda dhe jashtë në kopësht, koridoreve, dhoma, barreve, staza, lodrave, drunjëve, barit/ gjelbërimit, methojave, luleve, paisjeve të kopështit etj.
- Pastimin dhe zbrazjen e mbeturirave në kopësht.



7 -Mbajtja e higjenes së ulësëve, lodrave dhe paisjeve të kopështit.

- Përmirësimin e kushteve për qëndrim ditor, një mjedis të ngrohtë, të freskët dhe të rehatshëm sipas stinës dhe motit, duke ndihmuar përfutuesin e shërbimit në mirëmbajtjen e ambientit të brendshëm të institucionit duke bërë mirëmbajtjen e ngrohjes dhe freskësisë në të gjitha hapësirat brenda institucionit, koridoreve, dhoma, kuzhinës, sallës së ngrënies, banjave, etj.
- Pastimin dhe mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore/ radiatorëve.
- Mirëmbajtja e paisjeve dhe kalldasë.
- Këtu përfshihen edhe ljerja e objekteve kurë është e nevojshme, hyjet sanitare, kalldaja, paisjet dhe materialet higjienike për mirëmbajtje dhe pastim.

	Ore/h	800	2.00 €	1.600.00
Ore/h	800	1.70 €	1.360.00	



Gjithsejshëm € 24.880.00

Emri i Kompanisë		CIK - Caritas Kosova
Adresa e Plote		Rr. Shënë Nënë Tereza nr 3 Ferizaj
Përfunduar Nga:		Alfred Shkëmbi
Emri & Mbiemri		Alfred Pjethi
Pozita		Drejtori Ekzekutiv
Nënskrimi		
Data		03.11.2022
Vula		

KOMUNA SHTIME

NJOFTIMI PËR NENSHKRIMIN E KONTRATËS

FURNIZIM

PUNË

SHËRBIME

Sipas Nenit 41A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 17.11.2022

Nr i Prokurimit	617-22-11537-1-3-6
Nr i brendshëm	617-2022-099-136

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KOMUNA SHTIME		
Adresa Postare: Rr., Tahir Sinani,, Shtime		
Qyteti: SHTIME	Kodi postar: 72000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Feride Rexhaj		Telefoni: 0290-389-016-228
Email: prokurimi.shtime@gmail.com		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po

Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Po

Jo

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSIHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim zyrtar		
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit (Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)		
<input type="checkbox"/> Punë	<input checked="" type="checkbox"/> Furnizime	<input type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input checked="" type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve / Vendi kryesor i dorëzimit / Vendi kryesor i realizimit Furnizim zyrtar
II.1.3) Njoftimi përfshinë Krijimin e kontratës publike kornizë: Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj
II.1.4) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës Furnizim zyrtar
Vlera e parashikuar e kontratës: 2,459.00
Financuar: <input type="checkbox"/> Vetanake <input checked="" type="checkbox"/> Buxheti i Konsoliduar i Kosovës <input type="checkbox"/> Donacion
Kohëzgjatja e kontratës (data e fillimi dhe përfundimit) Ne dite: Ne muaj: 2 Data e fillimi: Data e përfundimit:
II.1.5) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 30241400-4

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

- E hapur
- E kufizuar
- Konkurruese me negociata
- E negociuar
- Kuotim
- Vlere minimale

III.2) KRITERET E DHËNIES

- Çmimi më i ulët *ili* Tenderi ekonomikisht më i favorshëm

NENI IV: DHËNIA E KONTRATËS

(Në rast të disa pjesëve të dhëna disa operatorëve ekonomik të suksesshëm, përsërit S IV.3, IV.4 dhe IV.5 për secilën pjesë)

IV.1) Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit: 11.10.2022
Data e publikimit të Njoftimit për kontratë: 21.10.2022
Data e hapjes së tenderëve: 26.10.2022
Data e publikimit të Njoftimit të dhënies së kontratës: 15.11.2022
Data e nënshkrimit të kontratës: Shih Nenin IV.3)
IV.2) Numri i kërkesave për tërheqje të Dosjes së Tenderit: 10
Numri i tenderëve të pranuar: Shih Nenin IV.3)
Numri i tenderëve të përgjegjshëm: Shih Nenin IV.3)
Afati kohor për dorëzim të tenderëve: <input type="checkbox"/> normal <input type="checkbox"/> i shkurtuar

IV.3) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, me të cilin është nënshkruar kontrata

Kontrata No.: 617-22-11537-1-3-6/C473
 Grupi No.: 1
 Grupi: Furnizim zyrtar
 Data e nënshkrimit të kontratës: 16.11.2022
 Numri i tenderëve të pranuar: 10
 Numri i tenderëve të përgjegjshëm: 10

Emri zyrtar: " INFINITT " SH.P.K.

Adresa Postare: Dëshmorët e Kombit

Qyteti: PRISHTINË

Kodi postar: 10000

Vendi: Kosovë

URL (nëse aplikohet):

Personi kontaktues:

Email:

Telefoni: 044/974590

Faksi:

IV.4) Informacione mbi vlerën e kontratës

Vlera e përgjithshme e kontratës **1,743.00** EUR

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët: **1,743.00**

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lartë: **3,216.70**

IV.5) A ka gjasa që kontrata të nënkontraktohet

Po **Jo**

Nëse po, vlera e kontratës apo përqindja që ka gjasa të nënkontraktohet

Vlera ; apo **Përqindja** %; **Nuk dihet**

[Empty rectangular box]

V) INFORMACIONET SHITESË

[Empty rectangular box]



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
Uprava za Urbanizam, Katastar i Geodeziju
Department of Urban Planning, Cadastre and Geodesy

Data/Datum/Date:	23.11.2022
Nr./Br./No	06/115
Për/Za/To:	Drejtorinë e Prokurimit Drejtor, Jeton Raka
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejtor, Grejtalb Emiri
Lënda/Predmet/Subject :	Vendim, për Menaxher të Kontratës dhe mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 9 paragrafi 1 pika g), si dhe nenit 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, i datës 01.02.2021, dhe Vendimit të ZKA nr. 02/70, të datës 25.03.2022 për autorizim për emërimin e menaxherëve dhe mbikëqyrësve të kontratave. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi merr këtë:

VENDIM

1. Emërohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Kontratës për kontratën: **Shërbime Sociale Edukative për Institucioni Parashkollor 'Albiona Asllani' Shtime**
2. Menaxher i Kontratës: **z. Fatmir Zymeri - zyrtar I financave ne arsim**
3. Emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës: **z. Lulzim Sahiti - Drejtor I Arsimit**
4. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, si dhe Manualet për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës;

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
I'u dorëzohet:

1. Menaxherit të Kontratës,
2. Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës;
3. Zyrës së Kryetarit;
4. Drejtorisë së Prokurimit.



0039708

NUMRI I POLICËS

039708

SIGURUESI

K.S. SCARDIAN J.S.C
Adresa:
Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristine,
Kosovo

AGJENTI

Ilirim Shaqiri
Adresa:
Rr. "Ahmet Kaçiku

I SIGURUARI

CARITAS KOSOVA
Adresa:
KISHA KATOLIKE REXHEP BISHIMI

NUMRI I BIZNESI I

5200022-0

NUMRI FISKAL

600246765

QËLLIMI I SIGURIMIT

Caranoi e Kontratës

PËRFITUESI

KOMUNA SHITIME

TITULLI I KONTRATËS

SHËRBIME SOCIALE EDUKATIVE PËR
INSTITUCIONIN PARASHKOLLORË
ALBIONA ASLLANI SHTIME

NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT

617-22-11698-2-2-1

TERRITORI I MBULIMIT

Republika e Kosovës

PERIUDHA E SIGURIMIT

164 ditë

SHUMA E SIGURUAR

2,488.00 EURO

Nga:

17-11-2022 00:00:00

Deri:

30-04-2023 23:59:59

PRIMI I SIGURIMIT

50.00

TVSH 18 %

0.00

PRIMI +TVSH 18%

50.00

DATA E LËSHIMIT

2022-11-17 11:59:56

VËREJTJE: NR I BRENDSEHEM 617-2022-109-221

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregulloreve dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendore e Republikës së Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësori i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me me policën e sigurimit.

Kjo policë sigurimi vërteton lidhjen e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të deklarimeve dhe kërkesave të bëra nga i Siguruari/përfaqësuesi i të siguarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruari/ përfaqësuesi i të siguarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se pajtohem me to, si dhe me të dhënat dhe përcaktimet e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI

CARITAS KOSOVA "CIK"

Pop Boshnjak

(emri, emri, nënshkrimi)



Pjesë përbërëse e policës: 039708

Për: KOMUNA SHTIME
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: CARITAS KOSOVA, KISHA KATOLIKE REXHEP BISLIMI
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE: NR I BRENDSEHEM 617-2022-109-221

**Titulli i aktivitetit të prokurimit: SHËRBIME SOCIALE EDUKATIVE PËR INSTITUCIONIN
PARASHKOLLORË ALBIONA ASLLANI SHTIME**
Numri i prokurimit: 617-22-11698-2-2-1

SIGURIA E KONTRATËS

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **2,488.00 EURO (DYMIJE E KATERQIND E TETEDHJETE E TETE EURO)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përbushja e njërit nga kushtet në vijim:


(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **2,488.00 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen prej **17-11-2022 00:00:00** deri **30-04-2023 23:59:59**

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:



SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë
Kosovë
2022-11-17 11:59:56

